

JEZUSI TË DO TY

TOMORAJETI

JEZUSI TË DO TY

E Drejta e Autorit © 2018 Tomor Ajeti.

Dizajni i kopertines: Mirgen Dhima

Ilustrimet: Susan Joy Lu

Përveç përkthimeve të parafazuara të autorit, të gjitha shkrimet në këtë libërth janë marrë nga Bibla.

"Citimet Biblike janë marrë nga Bibla, botim 1991-1994. E drejta e autorit ©SHOQËRIA BIBLIKE SHQIPTARE (A.B.S.)TIRANË. Përdorur me leje." Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ISBN 978-9928-4526-0-3

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër pa marrë leje me shkrim nga autori.

Për ta ribotuar këtë libërth kontaktoni me autorin:

Tomor Ajeti

Kutia Postare 104

Tirane, Shqipëri

Email: tomor.ajeti@hotmail.com

Tirazhi 1000 kopje

Botuar në Tiranë, Shqipëri

E vërteta më e madhe në botë



Nëse ka një të vërtetë më të madhe se kjo, unë ende se kam dëgjuar, por kjo është me të vërtetë një gjë e jashtëzakonshme: Jezusi të do ty. Kur i dëgjova këto fjalë për herë të parë seç lëvizi diçka brenda zemrës sime, as vet se kuptoj. Sikur dëgjova vet përshpëritjen e Zotit në thellësinë e shpirtit tim dhe fjalët e Tij: ‘Unë të dua Ty’. Uau! Ndoshta ty të duket paksa e çmendur thënia: “Jezusi të do ty”, por në fakt kjo është e vërteta më e madhe që ke për ta dëgjuar ndonjëherë në jetë.

Kur një djalë dashuron një vajzë, fjalët ‘të dua’ dalin kaq lehtë nga goja e tij, pa asnjë shtyerje ose detyrim. Por unë të them që nga goja e Perëndisë tashmë kanë dalë fjalë të tilla dashurie për ty sa që këto fjalë janë përjetësisht të vendosura në Bibël, që askush të mos i shlyejë kurrë, sepse kanë shumë rëndësi. Bibla thotë: Perëndia **KAQ SHUMË E DESHI BOTEN...**cilën botë? A mos po flet Perëndia gjë për planetet? Ose galaktikat dhe yjësinë?

Jo, jo miku im, Ai e kishte fjalën për ty, për ty që po e lexon këtë libërth të vogël në këto çaste.

Si e di unë këtë? Sepse Bibla vazhdon...*sa dha Birin e Tij të vetëmlindur, që KUSHDO që beson në Të të mos humbasë por të ketë jetë të përjetshme.* Ti je njëri nga 'kushdo-të' e kësaj bote, që Ai deshi dhe do edhe sot pa asnjë rezervë dhe unë dëshmoj gjithashtu që kjo dashuri është kaq e madhe dhe e pashtershme për njerëzit sa që vazhdon me shekuj të shekujve deri në mbarim të kësaj bote siç e njohim tani.

A të do Ai sepse ti je i mirë? Jo.

A të do Ai sepse ke bërë të mira në jetë? Jo.

A të do Ai sepse je i mençur ose sepse ndihmon të tjerët apo sepse shkon në një vend lutjeje? Jo.

Dashuria e Tij për ty nuk është e kushtëzuar nga ndonjë veprim ose mosveprim nga ana jote. Ai të do sepse *Ai është Dashuri.* Natyra e Perëndisë përbëhet nga substanca e dashurisë. Çdo pjesë e qënies së Tij është dashuri. Dhe

dashuria nuk mundet të bëj diçka tjetër përveçse të na dojë.

Dashuria nuk është ndjenjë, është më shumë se aq. Ajo është një lumë i pashtershëm që përpiqet t'i ujisë shkretëtirat e zemrave tona, sepse zemrat tona, që nga prindërit tanë të parë, Adami dhe Eva, u bënë shkretëtirë për shkak të mëkatit. Zemra jote është aq e etur për këtë dashuri, sa nuk e merr me mend sa shumë ka pritur që të dëgjojë dhe ta pranojë këtë dhuratë qiellore.



Provo dhe shih

Si është e mundur që flas me kaq siguri për dashurinë e Jezusit? Sepse e kam provuar! A keni provuar ndonjëherë hurmën farëzezë të Shqipërisë? Nëse po, atëherë do të binit dakord me mua se nuk ka frut më të shijshëm se ai. Po ullinjtë e Beratit? Po lakrorin e Korçës? Po djathin e Gjirokastrës? Po, po, jam i sigurt që ka specialitete shqiptare që keni provuar edhe ju nga zona juaj.

Pra dëshmia e vetme që kemi për cilësinë e diçkaje është ajo që kemi provuar vet. Bibla thotë: “Provojeni dhe shihni sa i mirë është Zoti; lum ai njeri që gjen strehë tek Ai.” (Psalmet 34:8). Pra ashtu si kemi provuar fruta të ndryshme dhe ushqime të ndryshme ne mund ta provojmë edhe mirësinë ose dashurinë e Perëndisë.

Ti ndoshta më thua: Unë nuk kam provuar asnjëherë mirësinë e Zotit dhe dashurinë e Tij në jetën time. Jeta ime është plot me probleme

dhe vështirësi. Ndoshta ndjehesh i vetmuar dhe nuk gjen mbështetje tek të tjerët, ose mund të jesh mirë nga gjendja financiare por jeta jote sociale është një lëmsh. Ke mbaruar shkollën *elartë*, dhe ndjehesh kaq *poshtë*. Ke bërë dhe masterin dhe ndjehesh sikur ke dështuar në marrëdhëniet e rëndësishme me familjen tënde. Atëherë ti ke nevojë për një reflektim. Ke nevojë të ndalosh dhe t'i bësh vetes ca pyetje të rëndësishme. Por para se shkojmë atje, le të vazhdojmë aty ku e lamë.

Ti mendon se nuk ke provuar mirësinë e Perëndisë në jetën tënde? Po prit pak. Unë mendoj ndryshe. Unë mendoj se ti tashmë e ke përjetuar atë, ashtu si edhe unë, jo njëherë por shumë herë, ndoshta edhe përditë, mirësinë dhe dashurinë e Tij. Si e di unë këtë? Ja tani do të ta shpjegoj.

Së pari, përderisa e lexon këtë libërth të shkurtër, kjo tregon se ti shikon, pra ke funksional dhe kjo është një dhuratë e jashtëzakonshme nga Perëndia që ti e ke. A e di se në botën e sotshme ka më shumë se

36 milion njerëz që janë të verbër? Përderisa kupton atë që lexon kjo gjithashtu është tregues aftësie intelektuale. Kjo është një tjetër dhuratë e Perëndisë. Nëse dëgjon, ose flet ose ecën me këmbët e tua, ose arrin të punosh me duart e tua, të gjitha këto janë pjesë e mirësisë së Perëndisë në jetën tënde. Ndoshta një vizite tek spitali i qytetit tënd, tek reparti i sëmundjeve të zemrës ose në toksilologji ose tek reparti i sëmundjeve të pashërueshme do të mund të të zgjoj ndaj mirësisë së Zotit që je duke përjetuar deri më sot.



Të thuash “Faleminderit”

Çfarë na verbon zakonisht ndaj dashurisë së Perëndisë? MOSMIRËNJOHJA. Të jesh mosmirënjohës ndaj mirësisë që përjeton çdo ditë nga Perëndia të bën të verbër ndaj dashurisë së Tij. Mos je gjë mosmirënjohës për gjendjen tënde personale?

Mos je më shumë i fokusuar tek ajo që nuk ke, sesa tek ato që ke dhe që i përjeton çdo ditë? Ti e di shumë mirë përgjigjen e këtyrë pyetjeve. Pra, nuk mund të thuash se nuk e ke provuar mirësinë dhe dashurinë e Tij. Po, është e vërtetë që mund të mos jesh plotësisht i ndërgjegjshëm për këtë dashuri por ja, tani ti e di përgjigjen : *Ti je i dashur nga Perëndia* dhe ke provuar dhe vazhdon ta provosh dashurinë e Tij përmes krijimit tënd përderisa shikon, dëgjon, ecën, punon me duart e tua, shijon ushqimin, arrin të fësh në mbrëmje (sepse edhe gjumi është dhuratë nga Perëndia), pra kjo është një listë faktesh që ti i ke ngjyer gishtat me ëmbëlsirat e Perëndisë.



Më do s'më do

Në lojën me origjinë franceze, “Më do – s'më do” zakonisht përdoret një lule margarite për të shikuar nëse një person i caktuar na do ose jo, apo për t'u siguruar edhe më shumë në dashurin e tij/ saj. Pasi e kemi marrë margaritën në duar, fillojmë dhe heqim petalet një nga një dhe përdorim fjalët: më do, s'më do, më do...e kështu deri në petalen e fundit ku shpresojmë se do të themi 'më do'. Por me Perëndinë nuk do të kesh kurrë nevojë ta bësh këtë gjë. A e di pse? Sepse Bibla na siguron që **AI NA DESHI I PARI!**

*Ne e duam atë, sepse **Ai na deshi i pari.** (1 Gjonit 4:19)*

Në një marrëdhënie dashurie midis një vajze dhe një djali zakonisht dikush është i pari që hedh shikimin tek tjetri ose e vëzhgon nga largësia, ose tërhiqet fillimisht (në këtë rast djemtë ka gjasa që tërhiqen të parët sepse është ana vizuale që i tërheq më shumë). Pra

duket se ka dikush që e bën hapin i pari. Por për këtë gjë Perëndia është ekspert! Ai nuk pret që ti ta hedhësh hapin e parë, sepse Ai tashmë e ka bërë. Përveç hapave të dashurisë dhe mirësisë së Tij që shikojmë në krijim çdo ditë, përveç asaj që mund të kesh përjetuar personalisht nga mirësia e Tij, hapi më gjigand i dashurisë së Perëndisë është dërgimi i Jezusit, Birit të Tij në tokë.

Jezusi është dashuria e mishëruar e Perëndisë. Jezusi është personifikimi i mirësisë së Tij ndaj nesh. Prandaj Jezusi është unik dhe mesazhi që Ai ka për ty është i jashtëzakonshëm. Nuk e gjen askund në asnjë besim tjetër në botë. Ti mund të kesh dëgjuar për Jezusin nga burime të ndryshme por i vetmi burim që tregon me besueshmëri historinë e tij është Bibla.

Arsyeja pse Jezusi duhej të vinte në tokë është më shumë sesa të na bënte një vizitë. Arsyeja pse Atij iu desh të vuante një vdekje të tmerrshme në kryq, të kundërshtohet nga njerëzit e vendit të tij, të poshtërohet nga

pushteti i asaj kohe dhe të derdhte gjakun e Tij, është shumë e thellë dhe hyjnore që të përshkruhet me pak fjalë. Por unë besoj që në këtë libërth të vogël do të ketë mjaftueshëm nga e vërteta e Tij që ta kuptosh se Jezusi e bëri të gjithën për shkak të dashurisë që kishte dhe ka për TY.



Tregomë dashurinë tënde

Kur nuk jemi të sigurt për dashurinë e dikujt, ne presim që ata të na e tregojnë dashurinë e tyre përmes diçkaje që bëjnë për ne. *Thuhet që dashuria është vepër.* Bie dakord me këtë. Nëse dikush na do ai/ajo e tregon këtë gjë përmes diçkaje që bëjnë për ne. A të kujtohet ndonjë moment kur nga dashuria që kishe për prindin shkon dhe blen diçka për të, për t'i gëzuar zemrat e tyre, ose blen një dhuratë për gruan ose burrin ose fëmijët e tu që i do shumë? Çfarë na shtyri ta bëjmë këtë? Çfarë na shtyn të bëjmë gjëra për të tjerët dhe ta tregojmë ndjesinë që kemi për ta? DASHURIA. Sa mirë që e ditkeni këtë të vërtetë!

Por ja që Perëndia e ka bërë edhe këtë para jush. Ai tregoi DASHURINË E TIJ NDAJ NESH në momentin më të vështirë të jetës sonë, në çastin kur nuk e meritonim asnjë grimcë të kësaj dashurie, Ai e tregoi atë përmes Birit të Tij, kur Ai u sakrifikua në kryq për ty.

Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne. (Romakëve 5:8)



Pse vdekja në kryq?

Edhe unë e kam bërë këtë pyetje. *Pse duhet të vdiste Jezusi?* Pasi shfletova historinë e Jezusit në Bibël, tërhiqesha kaq shumë nga jeta e drejtë e Jezusit, nga thëniet e Tij depërtuese plot me të vërteta që si kisha dëgjuar kurrë më parë. *Pse duhej ta vrisnin atë?* Pse duhet ta burgosnin, ta pështynin dhe rrahnin atë? Pse duhej ta kryqëzonin me kriminelët kur Ai nuk bëri gjë përveçse shëroi njerëzit nga sëmundjet dhe i çliroi nga vuajtjet e shumta që kishin. Si është e mundur që të vritej një njeri i tillë pa asnjë të keq? Por duke dëgjuar thëniet e Jezusit bindesha për diçka që nuk isha bindur më parë, për mëkatet që kisha bërë dhe për pasojat e tyre. Askush nuk më kishte thënë që sharjet e mia, gënjeshttrat dhe mallkimet, urrejtja dhe lëndimi i të tjerëve ishte mëkat. Mendoja se pasi të gjithë bëjnë pak a shumë të njëjtat gjëra, atëherë kjo sjellje e imja ishte në rregull. Por duke menduar edhe më thellë kuptova që mëkati im, ishte

përgjegjësia ime dhe unë meritoja dënimin e drejtë për të gjitha që kisha bërë.

Dhe cili ishte ky dënim pyesni ju? Bibla thotë që paga (ose ndëshkimi) për mëkatën është VDEKJA. Pra dënimi im i merituar për mëkatet e mia ishte vdekja dhe po të jetoja në kohën e Jezusit, kjo vdekje do të më vinte përmes kryqëzimit sepse kështu dënoheshin për vdekje kriminelët e asaj kohe. Jezusi u dënua me vdekje (me anë të kryqëzimit) së bashku me dy kriminelë të tjerë.

Ndoshta ti mendon se nuk ke mëkatuar kurrë dhe se je njeri i mirë por e ke shumë gabim miku im. Bibla thotë nuk ka asnjë të drejtë, AS EDHE NJË. Ndoshta ti mendon se mëkatet e tua nuk meritojnë dënim sepse i ke bërë në padituri ose i ke bërë sepse të tjerët të kanë nxitur ose thjeshtë ke marrë hakun për diçka. Bibla thotë që edhe ato njerëz që të tjerët i shikojnë si të drejtë sepse bëjnë të mira, edhe ato mëkatojnë. Nuk ka njeri që të mos ketë mëkatuar në këtë botë. Edhe ata që ne mund t'i quajmë shenjtorë, kanë mëkatuar.

Edhe apostulli më i madhe që Bibla njih, apostulli Pal thotë për veten e tij që ishte mëkatar *dhe i pari ndër ta!* Apostulli më i guximshëm në Bibël, Pjetri, thotë për veten e tij, '*jam njeri mëkatar*'. Nëse këta shenjtorë që dhanë jetën e tyre si martirë për Jezusin, e quajnë veten e tyre mëkatarë, atëherë unë dhe ti nuk kemi shans që të pretendojmë se jemi më të mirë se ata dhe që nuk kemi mëkatuar! (Për referenca biblike shiko :Luka 5:8;1 Timoteut 1:15;Predikuesi 7:20;Romakëve 3:10).

Miku im, sa do të doja që ti të ishe njeri pa mëkat dhe gjithë të tjerët që njoh rrotull meje, sepse atëherë edhe jeta ime do të ishte shumë më e mirë sepse do të isha i rrethuar me njerëz që kurrë nuk thonë një fjalë të pavend ose të keqe ose të rreme, që kurrë nuk bëjnë ndonjë veprim të keq ose të padrejtë, që kurrë nuk zemërohen dhe nuk mendojnë keq për dikë tjetër, që gjithmonë i binden ligjit, nuk shkelin shpejtësinë e lejuar dhe nuk harrojnë të paguajnë lekët e ashensorit dhe pastrimit

të pallatit, që kurrë nuk kopjojnë në testet e shkollës dhe nuk çojnë raporte të rreme në punë...Ah sa do të doja të isha i rrethuar me njerëz të tillë por ja që nuk i gjej dot! Nëse gjen një vend të tillë ku nuk ka mëkatarë, të lutem më njofto, sepse do të doja të vija aty *sa më shpejt*.

Besoj që tani arrin ta kuptosh që ti dhe unë dhe gjithë të tjerët kemi një problem shumë serioz, që quhet **mëkat**. Jo mëkati i dikujt tjetër por *mëkati yt*. Ky është problemi kryesor që ti dhe unë kemi. Është si ai mallkim që nuk hiqet dot derisa një fuqi më e madhe se ty ndërhyt dhe të çliron njëherë e mirë. Dhe dënimi për këto mëkate është **vdekja**. Ndoshta tani do të fillosh ta kuptosh më mirë, përse vdekja e Jezusit ishte e domosdoshme dhe e vetmja mënyrë sesi ne mund të shpëtonim nga dënimi i përjetshëm.

Dashuria e vërtetë të kërkon dhe të shpëton

Kur mendon për historitë si ajo e Spiderman-it, Batman-it, Superman-it dhe të ngjashme me to, gjithmonë kanë një personazh që do ta shpëtojë botën nga njerëzit e këqinj. Por sado që këto filma zakonisht përfundojnë në favor të rolit kryesor ne e dimë që problemi me njerëzimin është shumë më serioz sesa një person negativ. Problemi qëndron me ne - jemi ne që kemi këto dëshira të liga brenda vetes dhe shpesh i shkaktojmë vuajtje vetes sonë, pa ndihmën e të tjerëve. Grindjet dhe luftërat tek ne vijnë nga pasionet *tona* dhe jo nga ndikimi i të tjerëve. Ne vërtetë që kemi nevojë për një Shpëtimtar por që duhet të na shpëtojë jo nga dikush tjetër por nga vetja jonë! *Nga vijnë luftërat dhe grindjet te ju?. A nuk vijnë, nga pasionet që luftojnë ndër gjymtyrët tuaja? (Jakobit 4:1)*

Pra problemi është shumë thellë brenda zemrave tona, prandaj edhe zgjidhja e tij



duhet të vijë nga dikush që ka fuqinë e mbinatyrshme të na ndihmoj, pra nga vet Krijuesi i zemrës sonë që është Perëndia.

Kështu edhe ndodhi! Kjo ishte arsyeja pse Jezusi erdhi, të na kërkojë dhe të na shpëtojë. Ai erdhi në këtë botë në mënyrë të mbinatyrshme, pra jo me anë të vullnetit njerëzor por përmes një mrekullie të Perëndisë. U rrit në mes të popullit të tij në Izrael dhe në moshën 30 vjeç filloi të ndaj mesazhin e dashurisë së Perëndisë për njerëzit. Askush kurrë nuk ka folur si Jezusi. Askush nuk ka shpërndarë të vërteta të tilla si ato që Jezusi i ndau me botën. Qëllimi i ardhjes së Tij në tokë dhe mesazheve të Tij ishte që *të kërkojë dhe të shpëtojë atë që kishte humbur*. (Luka 19:10) Pra Ai erdhi për ty dhe mua, na kërkoi dhe na gjeti në një gjendje të humbur, të pashpresë, më thjeshtë se kaq nuk shpjegohet dot. Pra ne ishim të humbur sepse jeta jonë sundohej nga mëkati dhe errësira.

Por kur Jezusi thotë që do të *shpëtojë atë që kishte humbur*, çfarë do të thoshte kjo? Cila është humbja që Jezusi po flet. Kush janë të humburit e vërtetë dhe çfarë kanë humbur

ata? Jezusi e tha qartë: Ç'dobi do të ketë njeriu të fitojë gjithë botën, nëse më pas do të *humbë shpirtin e vet?* (Marku 8:36) Humbja më e madhe e njeriut është humbja e shpirtit tij/saj, një përjetësi pa Zotin. Kjo është ajo gjendje ekzistenciale e quajtur 'Ferr' ose vuajtja e përjetshme, të mos arrish ta shikosh kurrë Zotin dhe të mos e përjetosh dashurinë e Tij të përjetshme. Por kjo nuk është një gjendje që fillon pas vdekjes (siç imagjinojnë disa) sepse shpesh ndodh, besoj se keni dëgjuar për dikë që thotë: 'Ja bëri jetën ferr' - ose - 'ja nxiu jetën'. Pra Ferri nuk është vetëm një vend por edhe një gjendje frymërore që mund të përjetohet tani, ashtu siç mund të përjetohet edhe Qielli (ose Parajsja) në tokë, tek njeriu që është tashmë në paqe me Perëndinë.

Miku im, unë besoj që nuk ke dëshirë të jesh përjetësisht i humbur dhe nuk ke dëshirë të humbasësh shpirtin tënd. Prandaj dhe po lexon këtë mesazh të shkurtër sepse je i interesuar për gjendjen e shpirtit tënd dhe ke dëshirë të dish më shumë mbi këtë dashuri që Perëndia ka për ty. Vazhdo më tutje...

Zgjidhja e vetme

Jo vetëm që ishim të humbur por Bibla thotë që ne ishim edhe *pa forcë*. Çfarë do të thotë kjo? Ne nuk mund ta shpëtonim veten tonë, ne nuk mund t'i shlyenim mëkatet që kishim bërë. Nuk ka solucion tokësor që mund t'i lajë gënjeshttrat, mallkimet, veprat e këqija, mendimet e liga që ne i kemi bërë. Nuk ka solucion që mund të heq lëndimet që u kemi shkaktuar njerëzve të tjerë. Pra ne ishim të humbur dhe **pa forcë**. *Sepse, ndërsa ishin akoma pa forcë, Krishti vdiq në kohën e tij për të paudhët. (Romakëve 5:6)*

Dhe Perëndia duke e parë gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodheshin dërgoi Birin e Tij Jezusin, si e vetmja zgjidhje për shpëtimin tonë. Por shpëtimi do të vinte në një mënyrë që është shokuese për shumicën e njerëzve në botë. Edhe sot shume njerëz nuk e kuptojnë që shpëtimi do të vinte përmes flijimit të dikujt tjetër për ne. Ne zakonisht jemi mësuar nga filmat që heroi i filmit nuk



vdes. Po, ai mund të lëndohet dhe të rrezikojë jetën e tij, por të vdes kurrsesi sepse pastaj filmi nuk mbaron siç duam ne. *Por jeta nuk është film!* Jeta është shumë më reale dhe e vështirë për shumicën e njerëzve në botë që jetojnë në situata jashtëzakonisht më sfiduese se ajo ku mund të ndodhesh ti. Ka njerëz që jetojnë rrugëve dhe çdo ditë u mungon edhe buka e gojës. Pra janë *pa forcë* për të ndryshuar fatin e tyre edhe pse dëshira për tu çliruar nga kjo është e pranishme tek shumica e tyre.

Edhe ti je pa forcë për të bërë ndryshimin më të vogël për sa i përket natyrës tënde mëkatore. Por ky nuk është fundi sepse Perëndia ka zgjidhjen për ty dhe mua. Ajo që është e pamundur për njerëzit është e mundur me Perëndinë. Shpëtimi nga jeta e mëkatshme është i mundur përmes zgjidhjes së Perëndisë. ***Jezusi është zgjidhja e Perëndisë për ty.*** Pra zgjidhja nuk është një parim, një këshillë apo një formulë por është *një person*. Është biri i Perëndisë, Jezus Krishti.

Ai erdhi për Ty.

Ai jetoi një jetë të pamëkat për Ty.

Ai u poshtërua dhe u fshikullua për Ty.

Ai u kryqëzua për Ty.

Ai vdiq për Ty.

Dhe Ai nuk na ka për borxh që ta bënte këtë. A e dini ju se edhe brenda familjes suaj të afërt dhe miqve tuaj vështirë se do të gjenit dikë të vdiste për ju, sado që ju duan ose ju respektojnë. Shikoni se sa ju vizitojnë ose japin gjak në rast se ju duhet të shtrihen në spital. Disa akoma nuk kanë përjetuar vështirësi të tillë që ta shikojnë nevojën e të tjerëve. Por ndoshta ju më thoni: Po, kjo është vërtetë, ata as që e çajnë kokën për mua dhe nuk shqetësohen se çfarë do të ndodh me mua fare! Bota ku ne po jetojmë është e ftohtë dhe temperatura e saj vetëm sa shkon dhe *ulet*. Sot vështirë në fakt se vdes dikush për një njeri të drejtë, mbase ndonjë do të guxonte të vdiste për një njeri të mirë, por shumica e njerëzve nuk janë të mirë sipas standardeve të

Perëndisë dhe e pamë që nuk ka as edhe *një* të drejtë.

Këtu mund ta shikojmë rëndësinë e sakrificës së Jezusit në kryq. Ai vdiq për ty kur ti dhe unë ishim armiq me Perëndinë në mendimet dhe veprimet tona të mëkatshme. Unë nuk arrijë edhe sot ta kuptojë thellësinë e dashurisë kaq të madhe të Tij për ne. Është vërtetë e mahnitshme. Ai vdiq në kryq për ty dhe mua, për mëkatarë pa forcë, të padrejtë, të humbur dhe pa shpresë.



Nuk ka rrugë tjetër

Jam i sigurtë që disa njerëz mendojnë: “Mund të ketë edhe ndonjë mënyrë tjetër shpëtimi.” Disa thonë: “Pse duhet të jetë vetëm një rrugë?” dhe qëndrojnë aty. Disa mund të thonë: ‘Mua nuk më pëlqen kjo rrugë shpëtimi, do ta gjej vet rrugën time’. Bota ku ne jetojmë *duket* se na ofron shumë rrugë shpëtimi nga gjendja në të cilën ndodhemi. Prandaj edhe shumë rryma fetare, vende kulturi dhe sekte nga të gjitha llojet. Por Jezusi dallon nga të gjitha rrymat dhe lëvizjet në botë sepse mesazhi i Tij është unik.

Ai thotë: *“Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje. (Gjoni 14:6).*

A ka diçka të vështirë për të kuptuar në këtë thënie? Jezusi thotë që Ai është rruga për tek Ati, Ai është rruga për në qiell dhe askush nuk arrin të shkojë tek Ati përveçse nëpërmjet Tij. Ka shpëtimtarë të vetëshpallur përgjatë

historisë së njerëzimit por askush prej tyre nuk vdiq për ty.

Shumë prej tyre morën jetë njerëzish dhe nuk dhanë asgjë për ta. Askush prej tyre nuk vuajti për ty. Askush nuk pagoi një çmim kaq të lartë për ty. E dini pse? **Sepse askush nuk ju do kaq shumë.** Kjo është dashuri hyjnore. Jezusi të do kaq shumë sa ishte i gatshëm të flijohej për ty dhe të vuante për ty, që ti të mos vuaje dhe ndëshkoheshe për mëkatet e tua.

Po, e di, e di, ti ndoshta mendon që mëkatet që ke bërë janë aq të vogla, sa nuk ishte nevoja që Jezusi të vdiste për mua. Ti ndoshta mendon se mëkatet e tua janë të papërfillshme. Por e vërteta është që nuk ka mëkate të papërfillshme në Bibël. Bibla thotë që mëkatet meritojnë një pagë: *vdekjen*.

Dhe nuk ka mundësi për tjetër lloj pagese. Do të ishte shumë mirë po të kishte një mundësi tjetër pagese. Por me çfarë mund të paguhej? Me lek? Me euro? Me dollarë? Cilën valutë e kemi ne me aq bollëk sa janë mëkatet

e tona që ta përdorim si dëmshpërblim? Kush na qenka aq i pasur sa të mund të paguajmë për çdo mëkat që kemi bërë dhe bëjmë. Disa mezi ia dalin në fund të muajit të paguajnë faturat e ushqimit dhe qerasë sa që po t'ia shtojmë kësaj edhe faturën e mëkateve tonë, do të ngelnim në rrugë.

Ti dhe unë mund të jemi përpjekur të paguajmë për të këqijat tona duke bërë vepra të mira. Ka shumë njerëz që ende ecin me këtë mendësi : Bëj mirë dhe Perëndia do t'i heq të këqijat që bën. Kjo është rruga njerëzore por jo rruga e Jezusit. Po të ishte kaq e lehtë atëherë Jezusi nuk kishte nevojë të vinte dhe të vdiste për ne. Ne do të mund ta shpëtonim vetën pa ndihmën e Tij.

I bëni një pyetje vetes: A jeni vërtet kaq të mirë sa bëni të mira në çdo minutë të ditës suaj? Dhe atë të mirë që bëni, a ua bëni njerëzve *jashtë* familjes dhe faqfisnisë suaj, ndaj njerëzve që nuk i njihni dhe nuk ua kthejnë dot, apo mendoni se e mira që bëni është vetëm ajo që bëni për të dashurit tuaj?

Tu bësh mirë familjarëve nuk është vepër e mirë por është përgjegjësia themelore në një familje të shëndetshme. T'i duash fëmijët e tu dhe burrin ose gruan tënde nuk është një vepër e mirë sepse kjo është përgjegjësia e një njeriu që i funksionon mirë truri. Ose ta ndihmosh gruan duke larë enët, mund ta quash se 'bëre mirë' pasi e ndihmove atë?? Kjo është qesharake sepse ato enë që u bënë, ishin edhe të tuat!

Ta duash vëllain dhe motrën dhe t'i ndihmosh ata është përgjegjësia jote si pjestar i asaj familje. Por të bësh mirë? Kjo do të thotë të bësh mirë ndaj atyre që nuk ta kthejnë dot, si gratë e veja, fëmijët jetim, njerëzit e varfër dhe sëmurë që nuk kanë mundësi të na shpërblejnë.

Besoj që me këtë e kupton se veprat tona të 'mira' në krahasim me mëkatet e panumërta që kemi bërë që nga lindja jonë e më pas, nuk mund të shpengohen asesi.

Prandaj Jezusi thotë: Askush nuk mund të vijë tek Ati përveçse nëpërmjet Meje. Vetëm

Jezusi është Ai që mund të paguante për ty, sepse jeta e Tij ishte pa mëkat, e përsosur, e bindur deri në fund. Ai erdhi në Tokë që ta përmbushte misionin e pamundur nga ana njerëzore, pra shpëtimin tënd dhe timin dhe të të gjithë botës. Ai është unik. Dhe e gjithë kjo u bë për shkak se Ai të do ty.

Në hirin dhe mëshirën e Tij Ai të ofron edhe rrugën, dhe të fton, duke të thënë: *'Unë jam rruga, më ndiq Mua dhe do të vish tek Ati Qiellor'*. Kjo është ftesa më madhështore që mund ta kesh dëgjuar ndonjëherë. Zoti vet po të fton drejt vetes. Mos u lodh të kërkosh shpëtim në forcat e tua dhe veprat e tua. Ato nuk arrijnë kurrë ta shpëtojnë njeriun!



Perëndia dëshiron që ti të shpëtohesh

Nuk është e lehtë të kuptosh dashurinë, dhe në veçanti dashurinë e dikujt që nuk do të përfitojë asgjë nga ty. Përgjatë jetës ne mund të kemi përjetuar dashuriçka të vogla të cilat kanë pasur një kleçkë diku të fshehur nga pas dhe pastaj e kemi kuptuar se nuk ishte dashuri e vërtetë por një emocion rastësor, diçka imagjinare ose për më keq ndoshta një shfrytëzim. Por dashuria e Perëndisë nuk është e tillë. Ai të do ty personalisht edhe tani që ndoshta ende nuk beson tek Ai. Ai të do edhe pse ti ndoshta mund ta kesh përqeshur idenë e ekzistencës së Jezusit, ose e ke sharë Zotin dhe ke folur keq për të krishterët ose edhe për kishën. Ndoshta je produkt i frymës ateiste të komunizmit dhe e ke mohuar Perëndinë dhe je përpjekur ta fshish besimin nga zemra e shqiptarëve. Unë nuk e di të kaluarën tënde por e di këtë: Dashuria e Perëndisë nuk është e kushtëzuar nga veprat e tua ose nga sjellja

jote. Ai të do sepse ti je krijesa e Tij. Dëshira e Tij është që ti të shpëtohesh dhe të arrish në njohjen e së vërtetës. Kjo është dëshira e Tij.

Por cila është dëshira jote?

A dëshiron ti të shpëtohesh? A dëshiron të pranosh dashurinë e pakushtëzuar të Perëndisë? Kjo dashuri nuk është një ndjenjë por është e personifikuar në Birin e Tij, Jezusin. E gjithë jeta e Jezusit është dashuria në veprim, dashuria që vjen për ty, jeton për ty, vuan për ty, vdes për ty dhe në fund ringjallet për ty, për drejtësimin tënd. Bibla thotë që Jezusi jo vetëm që vdiq dhe u varros por ditën e tretë Ai u ringjall. Ringjallja e Jezusit vetëm tregon që dashuria nuk mund të shuhet, pavarësisht çfarë vështirësish kalon, nëse është dashuria e Perëndisë, ajo mposht edhe vet vdekjen.

Vendimi yt



Sot, nëse arrin ta kuptosh këtë dashuri të Perëndisë, ke edhe mundësinë ta pranosh atë. Po si mund të bësh këtë? Është shumë e thjeshtë, sepse ti je krijuar për ta pranuar këtë dashuri që nga fillimi. Edhe pse nuk e ke njohur Jezusin **më parë**, ti je krijuar për Të. Jezusi i ringjallur dhe i ngritur në qiell, të bën një ftesë personale sot: A dëshiron të jesh i lirë dhe në paqe me Perëndinë? A dëshiron të bëhesh fëmijë i Perëndisë? A dëshiron ta pranosh dashurinë Time dhe të jetosh me Mua në përjetësi?

Nëse përgjigja jote është PO, atëherë të ftoj ta bësh këtë lutje të thjeshtë si një ndihmë për ta shprehur dëshirën e zemrës tënde për Perëndinë.

Lutu kështu:

Perëndi i dashur, të falenderoj për dashurinë tënde. Faleminderit që dërgove Jezusin që të paguante për mëkatet e mia

dhe për shpëtimin tim. Faleminderit Jezus që tregove dashurinë tënde ndaj meje përmes vdekjes Tënde në kryq. Unë pendohem për të gjitha mëkatet që kam bërë dhe kërkoj ta pastrosh zemrën time nga çdo padrejtësi. Jezus, unë të pranoj Ty, si Zotin dhe Shpëtimtarin e jetës sime. Që sot e tutje do të besoj vetëm tek Ti dhe do të kërkoj t'i bindem Fjalës tënde të shenjtë, Biblës.

Perëndi i dashur faleminderit që më pranon dhe më bën fëmijën Tënd tani.

Në emrin Jezus unë lutem. Amen

Nëse e ke bërë këtë lutje me gjithë zemrën tënde, atëherë Perëndia ka premtuar që kushdo që *pranon* Birin e Tij Jezusin, Ai u jep *menjëherë* pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre pra që *besojnë në emrin e Tij. (Gjoni 1:12)*

Ti tani quhesh fëmijë i Perëndisë, si rezultat i dashurisë së Tij të madhe për ty(1 Gjoni 3:1)

Ky është vetëm fillimi i ecjes tënde të besimit! Jeta me Perëndinë fillon me dashurinë e Tij për ty, vazhdon me dashurinë e Tij për ty dhe kulminon në përjetësinë e dashur me Të. Kjo dashuri tani të bën që ta duash Perëndinë në të vërtetë dhe të duash fëmijët e Tij të tjerë, që mblidhen në kisha të ndryshme çdo javë në qytetin ose fshatin tënd.

Nëse në afërsinë e shtëpisë tënde nuk ka ndonjë kishë, atëherë mund të kërkosh për ndonjë kishë në qytetin ose fshatin e afërm dhe jam i sigurt që do të gjesh besimtarë të tjerë që besojnë në Zotin Jezus, me të cilët mund të kesh bashkësi të shenjtë. Zoti Jezus nuk na lë jetim në besimin tonë por ka një familje për ne.

Nëse nuk ke Bibël në shtëpi, jam i sigurt që në momentin që do ta kërkosh do ta gjesh në kishat tona shqiptare. Fillo dhe lexoje atë sepse ajo do të ushqejë frymën tënde si kurrë më parë.

Në rast se vërtetë ke pranuar Zotin Jezus në zemrën tënde, të përgëzohj dhe jam i lumtur për ty, sepse e di dhe e di që jeta jote do të ndryshoj për të mirë! Kjo ka ndodhur me mua dhe miliarda njerëz të tjerë. Gjithçka që Perëndia prek dhe bën, është e mirë, prandaj e di që nga Zoti Jezus vetëm e mira vjen në jetët e atyre që pranojnë.

Shpresa ime për ty

Ti ke marrë vendimin më të rëndësishëm në jetë dhe vendimi i dytë me rëndësi të lartë është vendimi që ta ndjekësh Atë çdo ditë. Në përvojën time si pastor për më shumë se 20 vite, duke punuar me shqiptarë dhe të huaj nga treva të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, kam hasur të krishterë që pas vendimit për ta pranuar Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar, nuk kanë vendosur që ta ndjekin Atë. Ata vendosën të jetojnë një jetë pa përkushtim, thjeshtë donin të siguroheshin se morën vizën për në Parajsë dhe u mjaftuan me kaq. Jezusi nuk është një vizë për në Parajsë! Ai është shumë më shumë se kaq. Ai ka përjetësinë në duart e Tij.

Ndaj para se e përfundojmë këtë mesazh të rëndësishëm, do të udhëzohj drejt një sekreti të suksesit në besimin tënd tek Krishti. Është sekreti i **vendimit të dytë**. Pra, sot merr edhe një vendim të dytë, mos u mjafto vetëm me vendimin e parë. Dhe vendimi i dytë është ky:

“Zoti Jezus, unë vendos që sot e tutje të jetoj për Ty ashtu si Ti jetove dhe u sakrifikove për mua.”

Ky vendim i rëndësishëm dhe i thjeshtë, ka qenë vendimi që më ka ndihmuar të shijoj të mirat që vijnë kur i bindemi Perëndisë me gjithë zemër. Ndaj mos jeto më vetëm për veten. Ke kaq vite që e ke bërë këtë! Tani ka ardhur koha për një ndryshim rrënjësor: Jeto për Zotin Jezus dhe Ai patjetër do të manifestohet dhe do ta bekojë jetën tënde.

*“...Ai ka vdekur për të gjithë, me qëllim që ata të cilët jetojnë, të mos jetojnë që sot e tutje për veten e tyre, po për Atë që vdiq dhe u ringjall për ta.
(2 Kor 5:15)*

Nëse ky mesazh ju ka prekur dhe keni vendosur të besoni në Zotin Jezus dhe ta ndiqni Atë, jeni të ftuar të vini për vizitë tek Kisha Ungjillore “Fitorja” në Tiranë.

Ju mund të kontaktoni me numrin e zyrës sonë:

00355682019027

ose me email: **qendrafitorja@yahoo.com**.

Ose përmes Mediave Sociale në Facebook ose Viber / Whatsapp gjithashtu.

Kisha “Fitorja” ju mirëpret në shërbesat e saj të rregullta.

Kemi gjithmonë një vend për ju!

Gjithashtu ju mund të kontaktoni me autorin në këtë adresë dhe të ndani dëshminë tuaj jetëndryshuese. Mirëpresim komentet tuaja gjithashtu!

Adresa e emailit të autorit:
tomor.ajeti@hotmail.com

Adresa postare e autorit:
**Tomor Ajeti
KUTIA POSTARE 104
TIRANE, SHQIPERI**

CIP Katalogimi për botim BK Tiranë

Ajeti, Tomor

Jezusi të do ty / Tomor Ajeti ; il. Susan Joy Lu. - Tiranë:

Qendra Kristiane "Fitorja", 2018

... f. : me il. ; ... cm.

ISBN 978-9928-4526-0-3

1.Feja kristiane 2.Jezu Krishti 3.Besimi

27 -184.3
